

Partneriteti me GIZ për Qendrën e Formimit Profesional



Partneriteti i Bashkisë Kamëz me GIZ, organizatën e mirënjohur gjermane për asistencë teknike e financiare në Shqipëri, me mbështetjen e drejtpërdrejtë të Ministrisë Federale për Bashkëpunim Ekonomik, ka konsistuar në projektin e rëndësishëm për ngritjen e një qendre rajonale të formimit profesional. Në fakt, projekt-ideja e krijimit të qendrës është iniciuar nga qeveria shqiptare dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe me mbështetjen e ambasadës gjermane dhe shoqatave gjermane, 2 vjet më parë, kur kanë filluar të kristalizohen linjat për arritjen e këtij objekti. Bashkëpunimi me Bashkinë Kamëz ka qenë në dy drejtime: së pari, të hidhen bazat për këtë kalim, nëpërmjet ngritjes së degëve të para të reja në shkollën profesionale ekzistuese dhe së dyti, paralelisht të gjendet trualli dhe burimet financiare për ngritjen e qendrës së re.



Dhe tashmë, mund të thuhet se në të dyja drejtimet janë bërë hapa përcaktues pozitivë. Shkolla ekzistuese ka pësuar ndryshime të dukshme (ngritja e degëve të shërbimit social, kujdesit shëndetësor, gastronomi, automekanikë, elektronikë, biznes mjedisor) që rriten në mënyrë të menjëhershme numrin e nxënësve në këtë shkollë, në këtë vit shkollor (rreth 200 nxënës të rinj). Për sa i përket truallit, kjo tashmë është përzgjedhur nga bashkia, në zonën që parashikohet të kthehet në një qendër komplekse arsimore, sociale e sportive. Për sa i përket fondit të ndërtimit, kjo është siguruar nëpërmjet qeverisë shqiptare në aplikimin për projektin IPA. Duke vlerësuar si tepër pozitivë hapat e hedhur, shoqata gjermane GIZ, në kuadrin e programit të ri për burimet mbështetëse në edukimin e trajnimin profesional, organizoi gjatë këtij viti një mision vlerësues, në dy faza kohore, për shkollën ekzistuese profesionale dhe ngritjen e qendrës së re

profesionale në Kamëz. Në fazën e parë eksperti i misionit hartoi një raport, që iu dërgua bashkisë, dhe që ishte rezultat i takimeve në ministri, bashki e shkollën profesionale. Në këtë raport vlerësohej dhe mbështetej krijimi i qendrës së re profesionale, duke vënë theksin në domosdoshmërinë e saj, në kushtet e një numri të madh popullsie me moshë të re në Kamëz, por edhe rajonin e saj përreth, si edhe në kushtet e zhvillimit të Kamzës si një zonë e re me perspektivë, që kërkon fuqi punëtore të kualifikuar.